D E K R E T
Nr.939, datë 11.10.1994

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7697, DATË 7.4.1993 "PËR KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE"

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993, neni 19 ndryshohet si vijon:

"Gjoba, të ardhurat që merren sipas neneve 6, 7 e 8 të këtij ligji, dhe shpërblimi i dëmit paguhen nga kundërvajtësi brenda pesë ditëve, nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet kamatë 2 për qind deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk paguhen, zbatimi bëhet nëpërmjet qendrës së punës së kundërvajtësit, duke përfshirë edhe punëdhënësit privatë".

Neni 2

Shtohet neni 19/a me këtë përmbajtje:

"Kur gjoba edhe detyrimet e tjera të parashikuara në nenin 19 të këtij ligji nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundravajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë.

Për gjobat e vëna mbi bazën e akteve të miratuara nga bashkitë ose komunat, dhe për gjobat e vëna nga organet e tjera shtetërore të ngarkuara me ligj që veprojnë brenda territorit të tyre, titulli ekzekutiv vihet në zbatim me urdhër të përgjegjësit të seksionit të financës nga punonjësit e ngarkuar posaçërisht për këtë qëllim.

Zbatimi i titujve ekzekutivë, kur është e nevojshme bëhet në bashkëpunim me organet e policisë së rendit.

Kur gjoba vendoset nga një organ shtetëror ekzekutiv i armatosur (policitë), gjoba zbatohet forcërisht me urdhër të titullarit të organit që e ka vënë atë".

Neni 3

Shtohet neni 19/b me këtë përmbajtje:

"Sekuestrimi i pasurisë bëhet në prani të kundërvajtësit ose të familjarëve të tij, të përgjegjësit të administratës të lagjes apo të kryeplakut të fshatit, dhe në mungesë të tyre, në prani të dy dëshmitarëve.

Nëpunësi i ngarkuar me sekuestrimin e pasurisë bën të ditur qëllimin e ardhjes, kërkon pagimin e gjobës përpara se të vihet dorë mbi pasurinë e të dënuarit, dhe kur e sheh të justifikuar kërkesën, ka të drejtë të shtyjë ekzekutimin deri në pesë ditë, duke lënë pasurinë mbi të cilën do të vihet sekuestro në dorëbesim të personit të dënuar apo të familjarëve të tij.

Përjashtohen nga sekuestrimi sendet që përcaktohen me dispozita të veçanta".

Neni 4

Shtohet neni 19/c me këtë përmbajtje:

"Kur nëpunësi i ngarkuar me sekuestrimin has në kundërshtimin e të dënuarit apo të

poseduesit të pasurisë, urdhërohet marrja forcërisht e sajë.

Për sekuestrimin e pasurisë mbahet procesverbal në të cilin përmenden personat e pranishëm dhe karakteristikat e pasurisë së marrë. Ajo transportohet e depozitohet në magazina ose dyqane për shitjen, që ngrihen për këtë qëllim. Vlefta e pasurisë caktohet me ekspertë të ngarkuar nga nëpunësi sekuestrues. Pasuria mund të shitet edhe me procedurë ankandi".

Neni 5

Shtohet neni 19/ç me këtë përmbajtje:

"Sendet që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e kundërvajtjes administrative ose që rrjedhin prej saj me vendim të organit që ka vendosur dënimin për kundërvajtje administrative, sekuestrohen dhe kalohen në dobi të shtetit duke i dorëzuar në rezervën shtetërore.

Neni 6

Shtohet neni 19/d me këtë përmbajtje:

"Sekuestro vihet mbi sende vlefta e të cilave plotëson pagimin e gjobës, të kamatave dhe të shpenzimeve të bëra për ekzekutimin e saj.

Në rast se sendi i sekuestruar është i ndashëm dhe rezulton me një vleftë më të madhe nga ajo që kërkohet, ndahet prej tij aq sa është e nevojshme për marrjen e gjobës e detyrimeve të tjera dhe shpenzimet e bëra, ndërsa diferenca i kthehet pronarit të sendit ose depozitohet në emër të tij".

Neni 7

Shtohet neni 19/e me këtë përmbajtje:

"Sekuestrimi i pasurisë së paluajtshme kryhet vetëm kur pasuria e luajtshme nuk mjafton për pagimin e gjobës.

Nëpërmjet zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nëpunësi sekuestrues njihet me pasurinë mbi të cilën mund të vihet sekuestro. Vlefta e saj duhet të jetë sa më afër madhësisë së gjobës.

Shitja e kësaj pasurie bëhet me anë ankandi, pasi më parë të jetë përcaktuar vlefta nga ekspertë të ngarkuar nga nëpunësi sekuestrues".

Neni 8

Shtohet neni 21/a me këtë përmbajtje:

"Bashkitë dhe komunat marrin masa për ngritjen e magazinave e të dyqaneve që kryejnë veprimtari depozitimi e shitjeje".

Neni 9

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDERFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha